

E njëjta procedurë ndiqet nga njësia përgjegjëse edhe në rastet e emërimit në mënyrë të përkohshme të në pozicione pune të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese nëpërmjet emërimit të:


- Nëpunësve civilë të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.
- Nëpunësve civilë të cilëve u ka përfunduar afati i pezullimit në përfundim të të cilit nuk janë rikthyer në vendin e mëparshëm apo nuk janë transferuar në një vend tjetër dhe që janë regjistruar në listën e cila administrohet nga njësia përgjegjëse.
- Nëpunësve civilë që kanë fituar të drejtën për rikthim në detyrë përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe janë regjistruar në listë pritjeje.



EMËRIMI I PËRKOHSHËM NË SHËRBIMIN CIVIL



Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë
Tel: +355 4226 8141
info@kms hc.al; kms hc@kms hc.al
www.kms hc.al

 04 226 8141

 kms hc@kms hc.al

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë



A lejohet emërimi i përkohshëm në shërbimin civil?

Emërimi i përkohshëm bëhet për ata kandidatë fitues, që nuk janë emëruar në një pozicion të rregullt sipas parashikimeve ligjore. Ata mund të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse në një pozicion pune i cili për arsye të parashikuara nga ligji, është vakant përkohësisht.

Cilat janë rastet që lejohet emërimi i përkohshëm?

Mund të emërohen përkohësisht në një pozicion të rregullt të shërbimit civil:

- Nëpunësit civilë të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.
- Nëpunësit civilë të cilët kanë përfunduar afatin e pezullimit dhe nuk janë rikthyer në vendin e mëparshëm të punës apo nuk janë transferuar në një vend tjetër të së njëjës kategori, të regjistruar në listen e pritjes që administrohet nga njësi përgjegjëse.
- Nëpunësit civilë që kanë fituar gjyqin, dhe me vendim gjyqësor të formës së prerë Gjykata ka urdhëruar rikthimin e tyre në detyrë, të regjistruar në listë pritjeje.

Cilat janë hapat që ndiqen për emërimin e përkohshëm?

Emërimi i përkohshëm në kategorinë ekzekutive realizohet si më poshtë:

Kandidatët fitues që nuk janë emëruar në një pozicion të rregullt sipas parashikimeve ligjore mund të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse, në një pozicion pune i cili për arsye të parashikuara nga ligji është vakant përkohësisht.

- Për administratën shtetërore, njësi e burimeve njerëzore e institucionit ku krijohet pozicioni i punës vakant në mënyrë të përkohshme, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, i drejtohet DAP-it duke e njoftuar për pozicionin e punës dhe shkahun e vakancës së përkohshme.
- Njësi përgjegjëse, përzgjedh nga grupi i administrimit të përgjithshëm/posaçëm, që i përshtatet kërkesave të vendit të punës, kandidatin fitues që ka mbetur në listë pritjeje. Përzgjedhja dhe njoftimi i kandidatëve bëhet në bazë të renditjes së tyre në listë sipas pikëve.
- Nëse kandidati fitues jep pëlqimin për emërimin e përkohshëm, njësi përgjegjëse nxjerr aktin e emërimit të përkohshëm në pozicionin e punës të propozuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike.
- Emërimi i një kandidati fitues në mënyrë të përkohshme nuk i heq atij të drejtën për t'u emëruar në mënyrë të përhershme në rast të krijimit të një pozicioni pune të lirë, gjatë kohës së vlefshmërisë së listës.
- Me përfundimin e emërimit të përkohshëm, kandidati fitues, detyrohet të bëjë dorëzimet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve pune.
- Emërimi i përkohshëm, pavarësisht kohëzgjatjes së tij nuk konsiderohet periudhë prove, në rast se kandidati fitues emërohet më pas në pozicion pune në mënyrë të përhershme.